

Mbi Auditimin e Brendshëm

Ushtruar në Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP-ve.

Njësia e Auditimit Brendshëm – Bashkia Shkodër bazuar në ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, VKM nr 212 datë 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, zhvilloi një mision auditimi të Kombinuar në Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP-ve Bashkia Shkodër, për periudhën 01 Janar 2015 deri me 31 Dhjetor 2018 nga auditimi rezultoi:

III. Permbledhje ekzekutive

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP-ve

Menaxhimi financiar dhe kontrolli

- Nuk ka miratuar rregullore të brendshme funksionale.
- Ka mangësi në regjistrin e riskut.
- Nuk ka përpiluar plan për kontrollin terren.
- Nuk ka realizuar objektivat planifikuara.
- Nuk ka propozuar tarifa për kullimin e ujitjen.
- Ka mangësi në përcaktimin e strukturës sipas funksioneve të Drejtorisë dhe në përshkrimin e vendeve të punës.

Menaxhimi i buxhetit

- Nuk është bërë planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të projekteve si dhe nuk janë ndarë sipas sipas klasifikimit administrativ, funksional dhe ekonomik.
- Nuk është bërë listimi i investimeve me koston e plotë të projektit, vlera financiare dhe vlera për financim.
- Nuk janë bërë planifikime 4-mujore për reliainin e buxhetit, si dhe nuk është informuar çdo 4 muaj nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues për realizimin e buxhetit.

Funksionimi i drejtorisë

- Nuk është hartuar regjistri i kadastrës së tokës bujqësore.
- Nuk ka përcaktuar tregjet për kafshët e gjalla.
- Nuk ka ndjekur procedurën ligjore për trajtimin e qenve e maceve të rrugës
- Nuk ka kriju data base për informacionin bujqësor e blegtoral
- Nuk ka ofru shërbimin këshillimor bujqësor e blegtoral

GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Gjetje : Referuar neneve 4, 5,11 të ligjit nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Anekseve të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me urdhërin e Ministrit Financave nr.108 datë 17.11.2016, Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP-ve - Bashkia Shkodër, duhej të kishte hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme të funksionimit, përgatitjen e planit vjetor të punës, përpilimin e hartës proceseve të punës, hartimin e regjistrit të riskut, planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, metodologjinë dhe listë kontrollet për vizitat në tërren, planin kontrollit brendshëm, nga auditimi i kryer ka rezultuar se ka mangësi në përpilimin e rregullores brendshme dhe miratimin e saj, ka mangësi në përpilimin e regjistrit të riskut, nuk është përpiluar plani i masave për minimizimin e riskut, nuk janë përpiluar liste kontrollet për vizitat në tërren.

Rekomandime:

a. Përshtatjen dhe miratimin e rregullores së funksionimit në përputhje me shembullin 01 të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me urdhërin e Ministrit Financave nr. 108 datë 17.11.2016.

b. Të kërkohet asistenca e koordinatorit riskut për Hartimin e regjistrit riskut, hartimin e planit masave për minimizimin e riskut.

c. Bazuar në planin vjetor punës të përpilohet lista e kontrolleve për vizitat në tërren.

2. Gjetje : Referuar, nenit 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeversjen vendore” germa “b” pika 4 neni 9 i ligjit 10296 date 8.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Drejtimi duhej të kishte përcaktuar, misionin, objektivat, dhe strategjine e Drejtorisë Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP-ve. Nga auditimi i kryer rezultoj se drejtimi ka përcaktuar, misionin, objektivat, ndërsa nuk ka përpiluar strategjine e zhvillimit të funksioneve si dhe nuk ka realizuar në fakt objektivat e paracaktuara .

Rekomandime:

a. Bazuar ne kërkesat e nenit 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeversjen vendore” Të përpilohet strategjia e administrimit, për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme. krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural.

b. Bazuar ne Strategjine e përpiluar te bëhet rishikimi i objektivave te Drejtorise , duke bere dhe korrigjimin dhe permirësimin e planifikimit të punës për vitin 2020 .

c. Bazuar në Strategjine dhe objektivat e Drejtorisë të bëhet propozimi për plotësim organike me specialiste të fushës përkatëse.

3. Gjetje : Referuar neneve 15,16-19 të ligjit nr.24/2017 Për administrimin e ujitjes e kullimit” Bashkia Shkodër, duhej te kishte shfrytëzuar dhe mirëmbajtur infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit , duhej të kishte plotësuar nevojat për ujë për ujitje, etj. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP-ve, duhet të kishte bërë propozimin për tarifim për kullimin dhe ujitjen e tokës dhe më pas të vendoste Këshilli Bashkiak. Nga auditimi i kryer rezultoi se është plotësuar vetëm pastrimi i kanaleve për disa zona me risk të lartë, nuk është bërë propozimi për tarifim të kanaleve kulluese dhe ujitjes.

Rekomandim: Të bëhet studimi për zbatimin e neneve 15,16-19 të ligjit nr.24/2017 Për administrimin e ujitjes e kullimit” të bëhet propozimi në Këshillin Bashkiak për tarifimin e kanaleve kullimit dhe ujitjes.

4.Gjetje: Referuar neneve 23 e 24 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin” drejtorja Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe trajtimit AMTP-ve dhe N/kryetari “ duhej të kishin ngritur sistemin e monitorimit dhe raportimit por nga auditimi rezultoi se kjo drejtori dhe N/Kryetari nuk kanë ngritur sistemin e monitorimit dhe raportimit me shkrim.

Rekomandim: Ngritjen dhe funksionimin e sistemit monitorimit dhe raportimit me shkrim(dokument nr. Prot. Datë), për të bërë të mundur evidentimin dhe raportimin në kohë të problematikave me qëllim përmirësimin e efëcencës te drejtorisë.

5.Gjetje : Në referencë të nenit 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqerisjen vendore”përshkrimi i vendeve të punës dhe plotësimi me organike duhej të ishte bërë sipas funksioneve që kryen bashkia Shkodër në fushën e bujqësisë. Nga auditimi kryer rezultoi se janë emruar 5 inspektor , duke vepruar në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr. 10.433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Rekomandim: Referuar funksioneve të bashkisë në Fushën e Bujqësisë të bëhet propozim me shkrim për rregullimin e organikës Drejtorisë Bujqësisë dhe pas miratimit organikës të bëhet rishikimi i përshkrimit të vendeve të punës.

6.Gjetje: Në reference të pikave 6,35,36,37 të udhëzimit nr. 23 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm në njësitë e Qeverisjes Vendore” Drejtuesi i Funkcionit në hartimin e projekt buxhetit, duhej të kishte përcaktuar a) Misionin e njësisë;b) Përshkrimin e programeve buxhetore dhe veprimtarive të njësisë së vetëqeverisjes vendore;c) kategorizimin e të ardhurave vendore; d) Shpenzimet sipas klasifikimit administrativ, funksional dhe ekonomik, sipas aktiviteteve;e) Qëllimet e politikës të programit, objektivat e politikës së programeve, produktet e programeve dhe kostot përkatëse, shoqëruar me treguesit e performancës. f) Planifikimin e shpenzimeve për çdo program sipas produkteve;g) Vlerësimin e kostove të politikave aktuale dhe atyre të reja, të planifikuara për financim nëpërmjet shpenzimeve buxhetore vendore vjetore dhe afatmesme;h) Informacionin për standardet e shërbimeve të ofruara nga çdo program buxhetor dhe nivelin e përmbushjes së tyre;i) shpenzimet kapitale, listën e projekteve të investimeve për çdo program me: i. koston e plotë të projektit; ii. vlerën e financiar deri në fund të vitit buxhetor paraardhës;

iii. vlerën e parashikuar për t’u financiar në vitin buxhetor korrent;

iv. vlerën e mbetur për t’u financiar në vitet pasardhëse buxhetore;v. burimet e financimit; . Nga auditimi i kryer rezultoi se: Drejtuesi i Funkcionit Bujqësisë në hartimin e projekt buxhetit, ka përcaktuar Misionin e njësisë; ka hartuar qëllimin dhe objektivat e projekteve ka bërë përshkrimin e programeve buxhetore.

Drejtesia i Funkcionit Bujqësisë nuk ka bërë planifikim të ardhurash, shpenzimet e projekteve nuk i ka ndare sipas klasifikimit administrativ, funksional dhe ekonomik, nuk ka përcaktuar, produktet e programeve dhe kostot përkatëse, shoqëruar me treguesit e performancës.Nuk ka dhënë Informacionin për standardet e shërbimeve të ofruara .

Drejtesia i Funkcionit Bujqësisë në shpenzimet kapitale, nuk ka bërë listimin e projekteve të investimeve, koston e plotë të projektit, vlerën e financiar deri në fund të vitit buxhetor paraardhës, vlerën e parashikuar për t’u financiar në vitin buxhetor korrent, vlerën e mbetur për t’u financiar në vitet pasardhëse buxhetore.

Rekomandime:

a. Projekt- buxheti i ardhshem për shpenzimet të hartohet si më poshtë:

1. Përpilim i qartë i misionit Drejtorisë Bujqësisë.
2. Përshkrim vecmas për të gjitha programet që kërkohet financim, në mënyrë të veçantë arsytet e përzgjedhjes programit, zona ku shtrihet, kohëzgjatja, përfituesit dhe risqet e mundshme që mund të paraqiten në zhvillimin e programit.
3. Shpenzimet duhet të paraqiten vecmas për çdo program, sipas klasifikimit administrativ administrativ, funksional dhe ekonomik, të ndarë sipas aktiviteteve (I gjeni publikuara ne faqen zyrtare të Ministrisë Financave).
4. Nëse projektet janë mbi një vit të bëhet ndarja e financimit sipas viteve (çdo vit deri në fund të projektit jepen të dhenat sa janë kryer shpenzime, sa shpenzime kryhen për vit aktual dhe sa shpenzime do të kryhen në vitet e ardhshme).
5. Shpenzimet të shoqerohen me vlerësim të treguesve ekonomik dhe të performances.
6. Të përcaktohet burimi i financimit.

b. Projekt- buxheti i ardhshëm për të ardhurat të hartohet si më poshtë:

1. Bazuar në ligjin e taksave vendore, ligjin e financave vendore, ligje të veçanta të Bujqësisë, ujitjes e kullimit, në të dhenat për tokën bujqësore dhe zhvillimin e tokës bujqësore, të përcaktohen të ardhurat e mundshme që mund të mblidhen sipas njësive administrative.
2. Nëse ka burime të të ardhurave të cilat nuk janë tarifuar dhe me ligj duhej të ishin tarifuar të bëhet kërkesë për përmirësimin e paketës fiskale.

7.Gjetje: Ne reference të pikave 31-33, shtojcave 1,2, të udhëzimit nr. 22 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarde monitorimit buxhetit, në njësitë e Qeverisjes Vendore”, Drejtuesi i nenfunksionit të bujqësisë, në monitorimin e buxhetit duhej të kishte kryer veprimet si më poshtë:

- Hartimin e planit katërmujor të produkteve në sasi dhe në vlerë duke respektuar tavanet e përcaktuara.
- Mbledhjen e të dhënave në lidhje me performancën e objektivave, performancën mbi secilin produkt në fund të katërmujorit dhe krahasimin e të dhënave faktike me planin e periudhës;
- Analizën e shkaqeve të mospërputhjeve/ shmangieve dhe marrjen e vendimeve në lidhje me veprimet korrigjuese, të nevojshme për përmirësimin e situatës;
- Në rast se një nga arsytet e shmangies ka qenë planifikimi i pasaktë atëherë është i nevojshëm rishikimi i planit dhe përgatitja e një përmbledhjeje të rishikuar katërmujore të shpenzimeve dhe realizimit të produkteve të programeve.
- Analizën që shpjegon mospërputhjet e rëndësishme në lidhje me planin e periudhës;
- Përmbledhjen e përditësuar të shpenzimeve dhe realizimit të produkteve;
- Rekomandimet për veprime të mëtejshme për përmirësimin e situatës që i propozohen GMS-së për vendimmarrje;
- Identifikimin e ndikimit të çdo ndryshimi në realizimin e planit të vitit buxhetor në përgatitjen e kërkesave për PBA-në e ardhshme;
- Organizimin e takimeve të ekipit të menaxhimit të programit në etapa të ndryshme të procesit të monitorimit, sidomos përpara periudhave të raportimit;
- Harmonizimin e qëndrimeve kur anëtarët e EMP-së kanë mendime të ndryshme në lidhje me situata të caktuara dhe raportimin të koordinatori i GMS-së nëse nuk harmonizohen qëndrimet;

- Miratimin e të dhënave që hidhen në mënyrë elektronike (instrument financiar ose *softëare* i përdorur për këtë qëllim)/data bazën e njësisë së vetëqeverisjes vendore për monitorimin e zbatimit të buxhetit.

-Mbi bazën e produkteve të përcaktuara drejtuesi i programit ka përgjegjësi të vlerësojë risqet që ndikojnë në arritjen e këtyre produkteve, mënyrën e trajtimit të tyre, si dhe kostot për minimizimin e risqeve. Risqet renditen sipas impaktit në realizimin e objektivit sipas të cilit është i lidhur produkti dhe diskutohen në Grupin e Menaxhimit Strategjik.

- Të përpiloje raporte 4 mujore sipas shtojcës 2 dhe të informojë nëpunësin autorizues. Nga auditimi i kryer ka rezultuar se kërkesat e mësipërme ligjore nuk janë respektuar.

Rekomandim: Me fillimin e vitit buxhetor, Drejtuesi i nënfunkcionit të bujqësisë të hartojë planin katërmujor të shpenzimeve, në sasi dhe në vlerë duke respektuar tavanet e miratuara, hartimin e afateve kohore sipas shtojcës 1 dhe hartimin e raporteve katër mujore sipas shtojcës 2 të udhëzimit nr. 22.

8.Gjetje: Në referencë të udhërit Kryetares Bashkisë nr. 996 datë 18.12.2017 “Për ngritjen e komisionit në verifikimin e gjendjes faktike të tokës bujqësore në Bashkinë Shkodër”, grupi i punës i ngritur për çdo njësi administrative, duhej të kishte Kryer verifikimin në terren, bazuar në librin e ngastrave, hartat kadastrale, listat e kryefamiljare me datë 01.08.1991, lista e familjeve që morën token në pronësi (formulari nr. 06), lista emrore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive, (formulari nr. 01), lista e pasurive të paluajtshme sipas numrit të pasurisë (printime të ZVRPP), gjendja faktike e tokës duke përfshirë ndryshimet. Grupet e punës në përfundim të punës së tyre duhej të plotësonin formularin, përfshirë, Numri rendor, zonën kadastrale, numrin e pasurisë, libri i pasurisë sipas LN-së, sipërfaqje sipas LN-së, emri mbiemri i pronarit, emri mbiemri i përdoruesit, si dhe sipërfaqen e tokës sipas pronarëve apo përdoruesve e ndarë në arë, pemishte, vreshtë, ullishte, truall. Për zbatimin e këtij vendimi janë ngarkuar Njësitë Administrative, Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Bujqësisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

Nga auditimi i kryer rezultoi se Drejtoria e Bujqësisë ka krijuar një regjistër për disa njësi administrative sic i kemi evidentuar më lart, ndërsa komisioni i ngarkuar për verifikim në terren nuk ka të dokumentuar (plotësimin e formularit bashkëlidhur urdhrin, informacionin drejtuar Kryetares Bashkisë për punën e kryer dhe për problematikat e hasura gjatë punës). Mos veprimet e grupit të punës bien në kundërshtim me pikën 3 të udhërit Kryetares Bashkisë nr. 996 datë 18.12.2017 “Për ngritjen e komisionit në verifikimin e gjendjes faktike të tokës bujqësore në Bashkinë Shkodër”.

Për moszbatim të urdhrin mbajnë përgjegjësi, grupet e punës të ngritura, Drejtorët e Drejtorive Bujqësisë, Të Ardhurave dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Rekomandime:

a. Grupet e punës të ngritura sipas njësisive administrative të plotësojnë formularin, që bashkëlidhet urdhrin, të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit, të përpilohet raporti, ku të evidentohen problemet e konstatuara si dhe të jepen mendime për përmirësimin e regjistrimit.

b. Pas përfundimit të procesit të evidentimit në terren, Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor dhe AMTP-ve të hartohë regjistrin e kadastrës sipas dhenave formularëve të përpiluara nga komisioni i evidentimit në terren.

c. Pas përfundimit të regjistrit kadastral të përpilohet regjistri i tatimpaguesve për tokën bujqësore, përfshirë taksat e tarifat.

Rekomandim: Të bëhet kërkesë me shkrim për plotësimin e organikës për përmbushjen e objektivave në dhënien e informacionit dhe këshillimin bujqësoro-blegtoral, si dhe nxitjen në krijimin e shoqatave të përdoruesve të ujit.

9.Gjetje : Në reference të pikës 2 germa “dh” të VKM nr. 230 datë 20.03.2013 “Për përcaktimin e funksioneve , detyrave specifike dhe standarteve të shërimit veterinar në qeverisjen vendore”, Bashkia në përmbushjen e detyrimit për shërbimin veterinar duhej të kishte punësuar të pakten 10 mjek veteriner, ndërsa nga auditimi lidhur me strukturën , janë angazhuar 2 mjek veteriner.

10.Gjetje: Në referencë të germa b, të nenit 54 të Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, pika III i VKM nr. 230 datë 20.03.2013 “Për përcaktimin e funksioneve , detyrave specifike dhe standarteve të shërimit veterinar në qeverisjen vendore”, Njësitë e qeverisjes vendore , përcaktojnë dhe bëjnë publike zonat e përshtatshme për ngritjen dhe funksionimin e tregjeve të kafshëve të gjalla në territorin që ata mbulojnë, ku duhet të ruhet një distance e përshtatshme minimumi 5 km nga qendrat e banuara dhe lidhje të përshtatshme me rrugët nacionale, njësitë e qeverisjes vendore verifikojnë e mbikëqyrin tregjet për funksionimin sipas legjislacionit. Nga auditimi i kryer rezultoi se Bashkia Shkodër nuk ka të përcaktuar dhe të publikuar zonat e përshtatshme për tregjet e kafshëve të gjalla.

11.Gjetje: Në referencë të pikës ç, neni 54 të Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, pika VI e VKM nr. 230 datë 20.03.2013 “Për përcaktimin e funksioneve , detyrave specifike dhe standarteve të shërbimit veterinar në qeverisjen vendore”,

Njësitë e qeverisjes vendore hartojnë programe pune të profilaksisë veterinarë në lidhje me situatën epizootike të qenve dhe maceve të rrugës, si dhe programe për kontrollin dhe lëvizjen e tyre.

Njësitë e qeverisjes vendore identifikojnë të gjithë qentë dhe macet e rrugës në territorin që ato administrojnë.

Njësitë e qeverisjes vendore organizojnë sterilizimin e organeve të riprodhimit të qenve e maceve të rrugës dhe grumbullimin e tyre në vende të posaçme, të miratuara nga autoritetet e qeverisjes vendore në zbatim të ligjit.

Njësitë e qeverisjes vendore organizojnë transportin e maceve dhe të qenve të rrugës me mjete që respektojnë standardet e mirëqenies së tyre drejt vendeve të miratuara nga autoritetet e njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast, këto mjete duhet të dezinfektohen me dezinfektantë të miratuar nga Drejtoria e Shërbimit Veterinar në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Njësitë e qeverisjes vendore kryejnë eliminimin e qenve dhe maceve të rrugës vetëm në rastet kur:

- a) shfaqin shenja klinike të sëmundjeve infektive;
- b) gjatë kontrollit për sëmundje zoonotike, kafsha paraqet rrezik për jetën e njeriut;
- c) kafsha është treguar tepër agresive dhe e egër, si dhe ka sulmuar njerëzit.

Eliminimi i kafshëve për rastet e përmendura sipas germave a,b,c, kryhet me metodën e eutanazisë nga mjeku veterinar që ushtron praktikën mjekësore veterinarë, duke përdorur një nga produktet mjekësore veterinarë të miratuara.

Nga auditimi i kryer rezultoi se trajtimi i qenëve të rrugës është bërë nga Drejtoria Shërbimeve Sociale e Strehimit dhe Shëndetit Pubylik, ku cdo vit janë hartuar specifikimet teknike, ku specifikimet teknike janë kryer nga specialiste të Drejtorisë Shërbimit Social të diplomuar për punë sociale e juridik. Janë hartuar preventiva , ku përfshihet, kapja dhe transporti, sterilizimi dhe kastrimi, vaksinimi dhe dehelmetizimi, matrikulimi, regjistrimi trajtimi, fotografohen dhe dokumentohen ne CD.

Rekomandime:

a.Të bëhet kërkesë me shkrim për plotësim me organikë specialist mjek veteriner dhe krijimit e sektorit të veterinarisë.

b.Të bëhet studimi, miratimi dhe publikimi i tregjeve për kafshet e gjalla.

c.Në Bashkëpunim me Njësitë Administrative, lagjet të të kryhet evidentimi i qenëve të rrugës , të hartohet preventivi për trajtimin e tyre sipas kërkesave ligjore, dhe nëse ka nevojë të bëhet kërkesë për shtesë fondesh për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit qenve e maceëve të rrugës.

12.Gjetje: Në reference të VKM Nr.253 DT.06.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave Bujqësore” pika 1 duhet të ish-in afishuar në vende publike apo botuar në një nga gazetet lokale ose të perditshem,lajmerimi publik për paraqitjen e dokumentacionit përshirë(kerkesen për AMTP ,planvendosjen e seciles ngaster,certifikaten e gjendjes familjare 01 gusht 1991,vertetim se ka qene banor me 1 gusht 1991.Drejtorja e Zhvillimit Bujqesor dhe AMTP duhet të kishte kërkuar zyrtarisht kopje të hartave kadastrale brenda juridiksionit të bashkisë shkoder ,ZVRPP e cila kjo e fundit duhet të dergojë hartat kadastrale Bashkisë Shkoder brenda 15 ditëve nga data e kërkesës.Nëse ZVRPP nuk disponon hartat duhet të ishte shprehur brenda afatit të me sipër. Drejtoria e Bujqesise,Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve duhet të kishte krijuar një regjister duke evidentuar kërkesat e paraqitura nga perdoruesit faktik të tokës bujqësore si dhe individit të cilët nuk kanë paraqitur kërkesë apo dokumentacion të cilët sipas të dhenave të ivenduara me parë nga DAMT rezultojnë perdorues faktik të tokës Bujqësore. Nga auditimi i kryer rezultoj se është bërë afishimi në vende publike dhe botuar në gazetë vendore apo të perditëshme për paraqitje e dokumentacionit për paisje me AMTP, e cila është kryer nga ish-komunat.

Nga auditimi i kryer rezultoi se Drejtoria e Zhvillimit Bujqesor dhe AMTP-se ka bërë kërkesë të një pas njeshme pranë Z.V.R.P.P Shkodër dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për venien në dispozicion të hartave treguese të regjistrimit të shkallës 1:2500(te azhornuara),librat e ngastrave,Lista e pronarëve të ndërtesave (formulari A1),por nga ana Z.V.R.P.P informacioni ka qene pjesor.

Nga auditimi i regjistrimit për përdorim faktik të tokës bujqësore,rezultoi që janë evidentuar personat që kanë bërë kërkesë për paisjen me AMTP,dhe nuk janë evidentuar të gjithë personat që janë përdorues faktik por nuk kanë paraqitur kërkesë.Rregjistri është mbajtur vetëm në mënyrë elektronike dhe nuk është printuar.

Rekomandime:

a. Drejtori i Drejtorisë e Bujqësisë ,Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve ,i cili është i autorizuar të përfaqësojë Bashkinë Shkodër pranë Z.V.R.P.P Shkodër,ne bashkëpunim me Z.V.R.P.P Shkodër te bëjë te mundur admininstrimin e dokumentacionit dhe informacionit të nevojshëm në zbatim të procedurave te VKM nr.253 DT.06.03.2013.

b. Te bëhet plotësimi i rregjistrit të perdorimit faktik të tokës,jo vetem me personat që kanë paraqitur kërkesë për paisje me AMTP,por të pasqyrohen edhe familjet bujqesore apo individet qe nuk kanë paraqitur kërkesë ,por sipas të dhënave rezulton të jenë përdorues faktik të tokës bujqësore.

13.Gjetje: Ne reference VKM Nr.253 DT.06.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore ne fshatrat e ish-kooperativave Bujqësore” pika 4 Drejtoria e Bujqësisë ,Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve ne reference te rregjistrit te krijuar sipas pikes 3 duhej te kishte kontrolluar nëse ne ngastrat e tokes bujqesore ne perdorim faktik është lëshuar me pare AMTP për përdorues të tjere,verifikon qenien subjekt ligjor i trajtimit me toke bujqësore etj.

Nga auditimi i kryer rezultoi se nuk është domkumentuar kontrolli i ngastrave të tokës bujqësore në përdorim faktik nëse ka patur me përpara AMTP për përdorues te tjerë,si dhe nuk është bërë verifikim i te qenurit subjekt për trajtim me tokë bujqësore.

Rekomandim: Të bëhet verifikimi i ngastrave të tokës bujqësore ne përdorim faktik për AMTP te lëshuara me parë për përdorues të tjerë,si dhe te behet verifikimi i personave qe disponojne tokë bujqesore në përdorim nese janë subjekt ligjor të tokës bujqësore ne pronësi.

Njësia Auditimit Brendshëm

Bashkia SHKODËR